



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:030974
Datë: 30.03.2024
Numri i dokumentit: 05528940

KPPP.nr.183/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati Shëndetësor, me adresë Instituti B, kati përdhësë, rrethi i QKUK-së në Prishtinë, kundër debitorit SPSH Rentgen Diagnostika Dentare Sh.P.K, L.F.I.N., me adresë në Pejë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.336/23 të datës 14.12.2023, të Përmbartuesit Privat Zija Bala me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 29.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit SPSH Rentgen Diagnostika Dentare Sh.P.K, L.F.I.N., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.336/23 të datës 14.12.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati Shëndetësor, me datë 14.12.2023, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.336/23, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues Vendimit të Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/NY-89-22 të datës 20.09.2022, me të cilin është obliguar debitori që menjëherë pas

pranimet të këtij urdhri, t'ia paguajë kreditorit shumën e borxhit në vlerë prej 2,000.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se i njejtë është nxjerrë në mënyrë të paligjshme, ngase vendimi mbi të cilin është lejuar përbarimi është dokument jo përbarues sepse nuk e ka vulën e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë dhe nuk është në origjinal. Më tej ka theksuar se vendimi i kundërligjshëm i nxjerrë nga kreditori Nr.10/NY-89-22 i datës 20.09.2022, nuk është fare vendim i përbarueshëm pasi procedura në këtë rast nuk ka përfunduar ende, dhe se kreditori nuk ka dërguar asnjë kërkesë apo përgjigje lidhur me ankesën e ushtruar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, ndërsa propozimi për përbarim të refuzohet në tërësi dhe urdhri përbarimor të shfuqizohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me nenin 22 të LPP-së, në paragrafin 1 nënparagrafin 2 është përcaktuar se dokumente përbaruese janë *“vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia...”*. Gjithashtu neni 23 paragrafi 2 i LPP-së ka përcaktuar se *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”*, kurse neni 24 paragrafi 3 i LPP-së ka paraparë se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është*

përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht Vendimin e Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/NY-89-22 të datës 20.09.2022, në bazë të së cilit Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi Nr.10/NY-89-22 i datës 20.09.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi Nr.10/NY-89-22 i datës 20.09.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarrueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Vendimi Nr.10/NY-89-22 i datës 20.09.2022, i nxjerrë nga Inspektorati Shëndetësor, është dorëzuar në origjinal, si dhe është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 14.11.2023, e cila vërtetohet nga vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Andaj, meqenëse në këtë çështje përmbarrimore gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarrues sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.183/24, me datë 29.03.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.